



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.66/2017

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragim Kadriu ne dëshitjen juridike te paditësit: nga [] , rr., nr. [] te cilen e perfaqeson [] nga [] , rr., nr. [] sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditures : Komuna e [] te cilen e perfaqeson Avokati [] Baza e kontestit: Vertetim pronesie, vlera e lendes se kontestit; 2.500,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.03.10.2017, jep kete:

AKTGJYKIM

-APROVOHET kerkespadia e paditësit: [] nga [] dhe **VERTETOHET** se paditesi, ne baze te shitblerjes ne vitin 1970 si dhe mbajtjes me mirrebesim mbi 20 vite eshte pronar i palujtshmerise parc.kat.nr. [] me kulture shtepi me siperfaqe prej 0.00.32 ha dhe oborr ne siperfaqe prej 0.00.48 ha ne vendin e quajtur R.ish. [] e cila evidentohet sipas qertifikates se pronesise 3300 ZK [] ne emer te te P.SH. Kuvendi Komunal []/1.

Detyrohen e paditura qe t'ia njoh kete te drejte paditësit dhe te njëjtit ti lejoj qe paditesi kete te drejte ta regjistroi prane Drejtorise per Gjeodezi dhe Kataster ne [] ne afatin prej 15 ditesh nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

Secila palc i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesi ne padine e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tij dhe scancat e mbajtura ka theksuar se : i ati i paditesit [] tani i ndjer qysh ne vitin 1970 ka blere palujtshmerine e cekur ne dispozitiv te ketij aktgjykimi. I ati i paditesit me familje te tij menjehere ka hyre ne posedim te kesaj patundeshmerie dhe te njejten e ka shfrytezuar pa pengese nga askush me familje si dhe te birin – tani paditesin .

Paditesi ne kete palujtshmeri ka shtepine per banim e cila gjate luftes eshte djegur dhe pas lufte perseri e ka ndertuar dhe te njejten e shfrytezon pa pengese nga askush . Tani von ka kuptuar se kjo palujtshmeri evidentohet ne emer te paditures.

Ne tjalten perfundimtare paditesi i propozon qe padine si dhe precizimin e kerkesepadise ta aprovoj si te bazuar nga se paditesi kete e ka fituar ne baze te shitblerjes si dhe me mbajtje me mirrebesim .

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk I kerkoj.

Perfaqesuesi I te paditures ne pergjigje te padise si dhe kerkesepadise se paditesit theksoi se: veshtruar natyren e kontestit konsideron se rasti si i tille duhet te trajtohet dhe te vendoset duke marr parasysh dhe ne konsiderat natyren e regjimit juridik te palujtshmerise , shtrinjen dhe pozicionimin e palujtshmerise ne zonen ekzistuese ne raport me karakterin ndertimor urbanistik si dhe gjendjen faktike ne teren .

Ne fjalen perfundimtare deklaroi se: vendimi duhet te jete epilog i rezultatit te provave.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme, veproi dhe pas administrimit dhe vleresimit te te njejtave ne baze te nenit 8. Te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet te vendoset si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne procedure e provave lexoi: certifikaten e pronesise P - te dt. 26.05.2017, ekspertizen e ekspertit gjeodet te dt. 26.05.2017, procesverbalin mbi kqyrjen ne vend te kesaj gjykate te dt. 19.05.2017 , kopjen e planit te dt. 26.05.2017, si dhe degjoi deshmitaret dhe dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga qertifikata e pronesise e sipercekur konstatohet : se palujtshmeria tani lendore evidentohet ne emer te paditures.

Nga ekspertiza e ekspertit gjeodet te sipercekur konstatohet se : pas matjes se parceles katastrale me nr. dhe shiqimin ne operatin katastral eshte konstatuar se prona e cila evidentohet sipas qerifikates se pronesise me nr. ne ZK , ku ne emer te Kuvendit Komunal eshte regjistruar edhe parcela katastrale me nr. me kulture shtepi me siperfaqe prej 0.00.32 ha , oborr me siperfaqe prej 0.00.48 ha , ne vendin e quajtur ,, R.i ,, . Paditesi e mban parcelen e sipercekur ne teresi ku ne kuader te ketij trualli eshte ndertuar edhe shtepia e banimit P + 0. . Me tutje nga eksperti ne fjale eshte vertetuar se palujtshmeria kontestuese e perbene parcela e cekur me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe skicen e terenit te cilat jane pjese perberese te kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga kopja e planit , shifet shtrirja dhe perkufizimi I palujtshmerise tani lendore.

Nga procesverbali mbi kqyrjen ne vend I kesaj gjykate I dt. 19.05.2017 konstatohet se: gjyqtari me vrojtim te drejteperdrejte konstaton se : palujtshmeria lendore gjendet ne parc.kat. , tani rr., , nr. I ku ne vend eshte shtepia perdhese e banuar . E njejta eshte e rindertuar nga se me heret ka qene e djegur gjate luftes ne kosove . E njejta eshte ne vije ndertimore me shtepite tjera dhe rreth e perqark jane shtepi private . E njejta shtepi eshte e perkufizuar fizikisht , rethekuar me gelendera dhe rrethoj te metalte. Kjo shtepi perbehet prej (1--dhome), (1- kuzhina) , (1- banjo) dhe (1- koridori).

Deshmitari deklaroi: Une kam pas hallen time ne lagjen ku gjendte ku e njejta ka jetu edhe me familje . e din qe babai i tij tani i ndjeri qysh ne vitet e 70-ta ka blere shtepine te cilen edhe sod e shfrytazon pa kurfar pengese nga askush . Gjate luftes shtepia eshte djegur dhe shkatruar mirepo prap e ka riparuar kete shtepi ne te eilen jeton edhe tani .

Deshmitari deklaroi: prejse e mban ne mend si I ashtu edhe babai i tij jetojne ne ate vend ku edhe tani i e ka shtepine perdhese . Keto rrethana iu jane te njohura nga se afer tyre ka pas hallen dhe ate perball shtepise se tyre ku shpesh ka shkuar dhe nga kjo baze edhe i di keto rrethana . Asnjehere as e as familja e tij nuk kane pas kurfar pengese apo mosmarreshje me kendo qofte . Gjate luftes kjo shtepi eshte djegur mirepo pas lufte eshte meremetuar -- rindertuar nga

Ne nje gjendje te ketill faktike te cekur me larte, gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi patundeshmerine tani lendore e ka blere i ati i paditesit tani i ndjeri qysh ne vitin 1970 nga shitesi me qmim te shprehur ne DM (20.000) ne baze te marrveshjes gojore te cilen qmim ne teresi bleresi iu ka paguar shitesit dhe qe nga momenti i shitblerjes i ati i paditesit si dhe paditesi e ka ne disponim dhe shfrytezim te lire kete patundeshmeri pa u penguar nga askush. Gjate luftes ne Kosove kjo shtepi eshte djegur si pasoj e luftes mirepo pas luftes po ne te njejtin vend paditesi serish e ka rindertuar kete shtepi e te cilen edhe tani e shfrytezon pa u penguar nga askush.

Nga provat e cekura me larte gjykata konstatoi se edhe pse kjo shitblerje eshte permushur 100% , kjo patundeshmeri juridikisht gjere me tani nuk eshte bartur ne emer te paditesit.

Ne mes paleve ndergjygyese nuk ishte kontestuese fakti se : nga e paditura nuk eshte inicuar ndonje procedure ndaj paditesit apo paraardhesit te tij lidhur me palutjeshmerine tani kontestuese .

Ne nje gjendje te ketille faktike te vertetuar me larte, gjykata kerkesepadin e paditesit e aprovoi ne teresi si te bazuar konform nenit 21 dhe 28 te LTHMPJ-es, Gaz.Zyrt RSFJ nr.6/1980 ne fuqi prej 1 Shtatorit 1980.(neni 90) deri me 20 Gusht 2009 (nenit 296-297 te Ligjit nr.03/L-54) mbi Pronesine dhe te drejtat e tjera sendore (Gaz.Zyrt. e Republikes se Kosoves nr.57/2009 ne Kosove ne fuqi nga 22 Marsi 1989 eshte Ligi I aplikueshem bazuar ne nenin 1.1 (b) te Rregullores se UNMIK-ut nr.1999/24.

Ne baze te nenit 21 te LMTHPJ-es, eshte percaktuar se : sipas ligjit pronesia fitohet nder te tjera edhe me mbajtje.

Ne baze te nenit 28.al.4. te te njejtin ligj, parashifet kalimi I kohes prej 20 vitesh per mbajtesin e ndershem. Ne baze te provave te cekur me larte e duke marre parasysh se kete palutjshmeri i ati i paditesit e ka blere ne vitin 1970 e qe nga ky moment i ati i paditesit si dhe paditesi e ka ne shfrytezim te lir gjere me tani, gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronsise nga ana e paditesit dhe ate : ne menyre originere , me mbajtje duke filluar qe nga viti 1970 e gjere me tani , nga se paditesi ka qen mbajtes I ndershem I kesaj palutjshmerie tani lendore, nga se ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise. edhe ne baze te mbajtjes : mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme dhe shfrytezimi I papengueshem I kesaj patundeshmerie.

Edhe ne baze te nenit 40 te Ligjit per pronesi dhe te drejtat tjera sendore (Ligji nr.03/L-154) eshte percaktuar se: personi I cili me mirebesim e ka 20 vjet ne posedim te panderprere nje palutjshmeri ose nje pjese te saj e fiton pronesin ne te.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore bazohet ne dispoziten e nenit 450. te LPK.

Nga si tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij akgyykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË
C.nr.66/2017 me dt.03.10.2017

Gjyqtari
Ragip Kadriu

KESHILLE JURDIKE : Kunder ketij akgyykimi mund te ushtrohet ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e pranimit . Gjykates se Apelit te Kosoves, e permese kesaj gjykate.